

Andreas Dushi

DROJA

Roman

Onufri

© Onufri, 2026

*Të gjitha të drejtat e botimit, në gjuhën shqipe,
brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë,
i takojnë Shtëpisë Botuese Onufri*

ISBN 978-9928-861-41-2

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Rr. "Konferenca e Pezës", Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë;
Tel & Fax 00355 42 220 017 / 270 399
www.onufri.com; E-mail: info@onufri.com

Çudi, kur rritemi, dhentë nuk flasin më.

Frederik Rreshpja

Unë i mjeri kam pas' drashtë

Se s'po di me ba dashni.

Tash që ia xuna fillin, o

Vendi n'vend s'po m'rrihet o...

Nga një motërzim i një kënge
popullore shkodrane.

A e mban mend njeri 0.facebook.com? Se si duhej të komunikonim me njerëz që nuk i shihnim, duke ua kujtuar a duke ua hamendësuar pamjen? E para histori e vërtetë dashurie për mua aty është jetuar, bashkë me alfabetin mors të zileve teke, dyshe a më shumë për të tejçuar një mesazh a përgjigje si dhe fundi i saj, me ofertat javore tremijëlekëshe te Vodafone, me radhë, një herë njëri e mandej tjetri.

Jam pesëmbëdhjetë vjeç dhe sapo ka filluar shkolla kur njihem me Milenën. Është shoqja e një vajze që kam në klasë. Te *party* i së shtunës, në dymbëdhjetë të drekës, vjen bashkë me të. Nuk është e ndrojtur, përshëndet gjithë miqtë e shoqes sime të klasës. Radha vjen tek unë.

Tani tek i rikthehem, hera e parë prej asaj kohe, më pëlqen të them se iu duka i pashëm, i gjatë, më kishte dalë edhe pak push si mustaqe mbi buzë. Milena, thotë shoqja ime e klasës dhe ajo më zgjat dorën. Gëzohem, them me qëndrim që dua të duket si prej të rrituri.

Pas pak, fillon kënga *I'm Sexy and I know It*. Ajo më afrohet. E marr si ftesë për kërcim. Ashtu është.

Hajde jashtë, sa t'pi një cigare, i them. Vjen. Don me ma dhanë numrin? e pyes. Jo, thotë, ashtë shumë shpejt. Si thu për Facebook? Ke? Kam. Ke ti? Po. Si e ke emrin? Mi Ylli, përgjigjet. E kupton se po e shoh me mosbesim. E mbaj tinzash, shton. Se nuk më lajnë prindtë. Je e vogël, thojnë. Mirë, qe, i them, po të baj ftesë itesh. Ashtë ai qi ka foto profilit një si lule, më sqaron. Eee, po s' mundem me e pa, se jam me xero facebook. Po pse, a ka shumë me kyt emër? Jo, në fakt. Vetëm unë.

Mbrëmja mbaron në katër pasdreke dhe atë vjen ta marrë i vëllai. Unë kthehem vetë. Rrugës, futem në tualetin e një lokali. Laj duart. Aroma e duhanit s'po u ikën. Gjej një *spraj* aromatizues për banjën dhe e hedh përmbi pëllëmbë. I nuhas. Diçka më mirë.

As nana, as baba nuk janë në shtëpi. Nona po vazhdon kotjen e zhegut, gjysmë zgjuar, gjysmë në gjumë. Futem në dhomë. Zhvishem. Shtrihem në krevet. Nxjerr celularin, Nokia E71. Hap internetin. Shkruaj lart te *search* 0.facebook.com. U hap. Shoh se Milena ma ka pranuar ftesën për shoqëri. I shkoj te profili. Nuk duket asgjë. Jo se kishte çfarë, në fakt, pasi ajo s'ka postuar ndonjë foto. Me sytë e ngulur ekranit drejtkëndor, ndiej *rrushin* të më forcohet. Ul mbathjet. I bie me dorë.

Flasim bashkë me mesazhe deri në mëngjes. Mbulohem i tëri me batanije. Nona nuk më vë re. As kur zgjatem të marr kordonin e karikuesit nga koka e ngulur te priza treshe që kalon mespërmes dhomës, gjumi nuk i trazohet.

Flasim e flasim pa pushim. Ajo sidomos. Ndryshe nga unë, ka shumë çfarë të tregojë. Për shembull, se si i ati i kishte vënë atë emër meqë i pëlqente shumë Franz Kafka, shkrintari. Sa më tha këtë, mendja më vajti tek Andreasi. Ishte më me motrën? S'ia kisha idenë. Te kisha vinte rrallë dhe, edhe kur rastisja aty, s'e pyesja dot, sepse prindërit ma kishin ndaluar të diskutoja me njeri për motrën. Po të pyti kush, thuji se ka ikë me shkollë jashtë. N'kjose ngulin kambë, gjej një vend, ku t'dush, po mos e zgjat. Ashtu sikurse më vjen në mendje, po ashtu më ikën sapo Milena fillon të më shpjegojë se kush është Kafka, pasi unë i them se është hera e parë që e dëgjoj. Harrohem nëpër ato fjali me kandrra e gjyqe, kështjella e kukulla, derisa përmendem, i lodhur, por i gatshëm të filloj tanimë

diskutim krejt tjetër, pasi i shkruaj cpb. je e lidhun? jo. po ti? as un.

Është mundësia ime. Është momenti im. Do t'ia dal.

Ashtu vazhduam të komunikonim. Marr vesh se është katolike, rri në Giuhadol dhe ka një lidhje të largët me familjen e një gruaje që i qep fustane nonës.

Më në fund, ma jep numrin. Për një javë, ruaj pesëqind-lekëshat në shkollë. Kam dy mijë e pesëqind lekë. Pesëqind m'i fal nona. Kështu, bëj ofertën.

Alo? Si je? përgjigjet. Zërin, çuditërisht, ia mbaj mend shumë saktë. Mirë... Dhe flasim e flasim. Dikur, minutat mbarojnë. Kalojmë prapë në 0.facebook.com.

a dona me u taku njajher?

kam frik

ke?

bben. baben*. nuk di ca me i than

thuji se don me dal

po ashtu s'mlen

del me vllan

paa, e ke gjet. me ttaku ty me te m padit fill

po nkjose vjen te kisha?

e ca me ba te kisha?
ose te ai dyqani perball. hajde me ble e tpres aty afer
un e takohena

prit iher tju tham

Pres. Pres. Pres.

mir thojn po bahem gati e po vi

Jam në ajër. E ndiej tamam si një të dashur. Madje, edhe më shumë: si një të dashur për të cilën më ka marrë malli. Rregulloj flokët, nuk di si më ngatërrohen duart, shtrij fort trikon me pëllëmbë, sikur e hekuros dhe jam gati, përballë krytit të Giuhadolit, në pritje.

Pas dyqanit të petëve, e shoh dhe e njoh. Zemra po më del nga vendi. Mezi ngopem me frymë.

Milena, si je? Lëviz lehtë kokën me duar në xhepa, pa e parë në sy, se mos na sheh kush. Mirë, përgjigjet dhe më kalon një hap para. Ul kokën, buzët besoj se nuk i duken prej përballë. M'paska marrë malli, shton. Edhe mu, shumë.

Dy-tre hapa, në heshtje.

Milen, si thu, a lidhena?

Mirë.

Ajo futet në dyqan. Unë vazhdoj drejt, deri përballë cepit të arqipeshkvisë, pastaj kaloj rrugën për te kisha. Nuk më besohet. Ajo. Milena. Milena është e dashura ime. Është e dashura ime. E dashura ime. Një vajzë. Një vajzë është e dashura ime. Unë. Unë jam lidhë.

Flasim e flasim me po atë shpeshti, deri në pranverë. Shihemi shumë rrallë, përherë në mënyra të njëjta a të ngjashme si ditën kur u lidhëm. Njëherë, në fakt, pimë një kafe te Floja. Unë domethënë piva kafe, të dukësha më i madh. Ajo hëngri akullore.

Dikur, si duket, na mbarojnë të gjitha bisedat që mund të bëjnë dy pesëmbëdhjetëvjeçarë. Prandaj vetëm sa i buzëqeshim njëri-tjetrit. Nja gjysmë ore kështu. Pastaj ndahemi. Për t'u takuar sërish në verë.

Jam, si çdo vit, në Velipojë. Edhe Milena. Po rri te disa kabina dy rrugë larg kabinave ku rrimë ne. I ka ardhur një kushërirë, Stela. Sigurisht, nga Italia. I ka treguar për mua. Mbrëmjeve, ndonjëherë, i lënë të dalin bashkë. Sikurse sonte. Më thotë. Vete, i ngazëllyer, t'i takoj.

Ku po shkojmë?

Si thoni te bregu?

Mirë, të dyja.

Ulemi në dy shezlongë. Unë me Milenën në një, ballë për ballë njëri-tjetrit. Stela tek ai pranë. E vë re që po na bezdis, ose, mbase, e ndjen veten të tepërt. Po iki tek uji, thotë.

Shihemi në sy, pa pushim, si të ishim tuj u hangër syshë. Me qejf, e pranoj disfatën. Sapo i mbyll, ende pa e plotësuar ciklin e pulitjes, ndiej gishtat e hollë mbrapa veshëve, bëj pak pas, fryma e saj më fryn në fytyrë, gishtat e dorës eshtake më tërheqin, buzët na bashkohen, dallgët përplasen, Stela na bën fotografi dhe buzët nuk na ndahen. Kjo ka qenë puthja ime e parë. Shumë poetike? S'dua t'ia di, kështu më pëlqen ta kujtoj.

Prej asaj nate korriku, flasim gjithnjë e më rrallë.
Thjesht, s'kemi më për çfarë të flasim. Nuk është nevoja
të thuhet, besoj, se s'u pamë tjetër herë.

Në shtator fillon shkolla. Një natë para ditës së parë të saj, i kërkoj të ndahemi. Më shkruan

e pse?

pse?

e?

psr?

pse?*

ca tkam ba?

e?

pse don mu nda?

ca ke?

ke gjet njaj tjetër?

Ata pak megabite të ofertës më kanë mbaruar prej kohësh. S'e gjej dot se si i bëhet block dikujt nga 0.facebook.com. Nana e baba janë në kuzhinë, po shohin Portokallinë. Shkoj te dhoma e tyre fshehurazi, pasi ata mendojnë se tani po fle, ndez kompjuterin, hap Facebook-un dhe më në fund, e bllokoj Milenën.

Nuk e di si ka mundësi, por as s'e kam parë më, as s'kam dëgjuar kurrë më prej saj.

Kohë më vonë, gjej pas derës së universitetit, një djalë që më pret.

Ma ban hallall, më thotë, por për shumë kohë, kur kena kenë ma të vegjël, të kam pritë për me të rrahë e s'kam dashtë me të pa me sy.

S'di si t'i përgjigjem. Ai e kupton, ndaj vazhdon: Ke pas dalë me Milenën atëherë, e unë kam kenë i fiksum mas saj, po ajo s'ma varte. Kur kam pas marrë vesh se del me ty, u bana i marrë, më iku mendja e thosha se ba me të pa, kam me të vra. Atë vit erdha edhe te kampi veror i katedrales, se mora vesht që ti shkoje në katedrale, por nuk ishe.

Vërtet, sepse kisha qenë në Velipojë, me Milenën.

Kot krejt më ke pas pshtu, për besë t'Zotit.

Unë prapë nuk flas.

A e din pse po të kërkuj falje? Se kam hi në seminar, du me u ba prift e s'mund ta bari ndjesinë e fajit që më krijon ideja se të kam pas inat.

Të shkoftë mbarë, i them dhe largohem.